



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA  
PROGRAMI I LËNDËS



KULTURA DHE ETIKA NË KOMUNIKIMIN ADMINISTRATIV

**Ngarkesa:** 4 ECTS | 20 orë mësimore | 20 orë leksion | 20 orë seminar - **Moduli 1:** 10 leksione + 10 seminare & **Moduli 2:** 10 leksione + 10 seminare

**Viti akademik / semestri kur zhvillohet:** Viti II, Semestri I

**Lloji i lëndës:** E detyrueshme

**Programi i studimit:** Master Profesional në “Komunikim Administrativ (në Institucione dhe Ndërmarrje)”

**Kodi i etikës:** Të gjitha veprimtaritë akademike në këtë lëndë zhvillohen në përputhje me Kodin e Etikës së UT-së, veçanërisht Nenet 4, 6, 7, 9

**PËRMBLEDHJE E LËNDËS:**

*Objektivat e përgjithshme:* T’u ofrojë studentëve njohuri mbi kulturën organizative, komunikimin ndërkulturor dhe etikën profesionale në mjediset administrative dhe institucionale. Të zhvillojë aftësinë e studentëve për të komunikuar në mënyrë efektive, gjithëpërfshirëse dhe etike me qytetarët, kolegët dhe partnerët institucionalë. Të aftësojë studentët për të identifikuar dhe menaxhuar dilemat etike, konfliktet e interesit dhe çështjet që lidhen me etikën digjitale, mbrojtjen e të dhënave dhe përdorimin e inteligjencës artificiale.

*Objektivat specifike*

1. Të njohin dhe analizojnë ndikimin e kulturës organizative, faktorëve ndërkulturorë, shumëgjuhësisë dhe stileve të drejtimit në komunikimin administrativ.
2. Të zbatojnë parimet e etikës profesionale, transparencës, integritetit dhe përgjegjshmërisë në marrëdhëniet institucionale dhe në shërbimin ndaj qytetarit.
3. Të zhvillojnë aftësi për analizimin dhe zgjidhjen e situatave praktike, duke përfshirë konfliktin e interesit, dilemat etike, mbrojtjen e të dhënave dhe përdorimin e përgjegjshëm të teknologjive të reja.

*Rezultatet e pritshme*

Në përfundim të lëndës, studenti do të jetë në gjendje të shpjegojë dhe analizojë konceptet kryesore të kulturës organizative, komunikimit ndërkulturor dhe etikës profesionale, duke i lidhur ato me situatat konkrete të komunikimit administrativ. Do të jetë në gjendje të zbatojë parimet etike dhe të komunikimit gjithëpërfshirës në marrëdhëniet me qytetarët, kolegët dhe partnerët institucionalë.